



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:282764

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05686586

C.nr.2053/22

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit A.H., nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokat në Prishtinë, rruga “Fehmi Agani” Hy-25/4, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria Komunale e Arsimit, në çështjen juridike: kompensim mbi bazën e përqindjes së inflacionit, jashtë seancës, më 15 maj 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.H., nga Gjakova.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të lartcekur, t’ia paguaj në emër të pagesës shtesë - përqindjes së inflacionit shumë prej 738.79 euro, shumë kjo e cila i referohet periudhave si në vijim:

- për periudhën janar-dhjetor 2020 shumë prej 10.10 euro;
- për periudhën janar-dhjetor 2021 shumë prej 172.11 euro;
- për periudhën janar-nëntor 2022 shumë prej 556.57 euro.

të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data 23.12.2022 (data e paraqitjes së padisë) deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 228.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës mbi shumë e gjykuar si në pikën II të këtij aktgjykimi dhe atë në shumë prej 1,022.19 euro, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarve të tij në padinë e parashtruar në gjykatë me datë 23.12.2022, ka parashtruar se është në marrëdhënie pune me të paditurën në shkollën “...”, në Gjakovë. Kanë shtuar se me nenin 35 paragrafi 10 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se “Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit...[]...dhe përqindja të futet në pagë”. Andaj, meqenëse e paditura nuk i ka përmbushur pagesën e përqindjes në emër të inflacionit, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’iu kompensoj shtesën në pagë në emër të inflacionit sikurse në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë të parashtruar me datë 18.12.2023.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar

E paditura përmes të autorizuarës se saj në përgjigje në padi të paraqitur në këtë gjykatë me datë 27.12.2023, në të cilën ka parashtruar se kontrata kolektive në të cilën është thirrë paditësi nuk ka fuqi ligjore ngase është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi nga Ligji i Punës. Ka shtuar se kërkesa për pagesën e shpërblimit në bazë të inflacionit në pagë nuk i takon paditësit më asnjë dispozitë ligjore e cila rregullon marrëdhënien e punës. Ka shtuar se kërkesa e paditësit është e parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës. Tutje ka parashtruar se Komuna e Gjakovës nuk ka qenë nënshkruese e kontratës kolektive të arsimit, andaj edhe kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar në raport me të paditurën Komuna e Gjakovës. Tutje ka theksuar se kërkesëpadia e paditësve është në kundërshtim me nenin 5, 37 dhe 38 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e po ashtu është në kundërshtim me nenin 46, paragrafi 1, 2, 3, 5, 7, dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit. Me propozim për gjykatën që konform nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar (për me tepër sikurse në përgjigjen në padi të datës 28.02.2023).

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “.....” në Gjakovë, si mësimdhënës i mësimit klasor. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.20%, për vitin 2021 ka qenë 3.40%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.60%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjen e inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2020 deri në vitin 2022 (brenda kërkesës së paditësit) sipas përlllogaritjes si në vijim :

- Për periudhën janar-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.20%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2020 ka qenë

421.00 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 10.10 euro, apo 0.84 euro për çdo muaj ($421 * 0.2\% * 12 = 10.10$)

- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.40%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 421.84 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 172.11 euro, apo 14.34 euro për muaj ($421.84 * 3.4\% * 12 = 172.11$).
- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.60%, andaj duke e llogaritur pagën e paditësit sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 436.18 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 556.57 euro, apo 50.60 euro për muaj ($436.18 * 11.6\% * 11 = 556.57$).

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.01.2020 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj

prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësin.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, mirëpo i njëjti pretendim ishte i pabazuar, ngase për kërkesat e parashtruara nga paditësi parashihet afat 3 vjeçar sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, ndërsa shikuar precizimin e kërkesëpadisë dhe dispozitën ligjore të lartcekur, gjykata erdhi në përfundim se nuk kemi të bëjmë në këtë rast me parashkrim të kërkesës.

Sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës në lartësi prej 1,022.19 euro gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se paditësi as me padi, as në precizimin e padisë nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar këtë lartësi të kërkesës, sipas detyrimit të përcaktuar me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga viti 2020, duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në vitin 2022 (*shtimi dinarik*), për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që paditësit iu njohën shpenzimet në shumë prej 228.00 euro, shpenzime

këto të cilat iu referohen shpenzimeve si në vijim: për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, për përpilimin e parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë 104.00 euro, si dhe për takse gjyqësore për padi, shumë prej 20.00 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2053/22, më 15 maj 2024

GJ Y Q T A R

Durim BALAJ

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.